

VENDIM
Nr. 81/2022

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR “PËR HARTIMIN E SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË LIGJIN NR.
15/2015, ‘PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015, ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015 ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, për një periudhë 3-mujore nga data e mbarimit të afatit të caktuar në vendimin nr. 66/2022 të Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 31.10.2022.